

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË**  
**PALUAJTSHME KAVAJË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë**, me objekt: *“Mbi procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 30.9.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 61, datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 938/11, datë 30.06.2014, i ka rekomanduar z. Seit Cikalleshi Drejtor i ALUIZNI Durrës, zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA PËR PËRMIRËSIM LIGJOR**

1. Nga ZQRPP të hartohen, përditësohen e miratohen:

a. Rregullorja për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 e ka humbur aktualitetin dhe nuk është e përshtatur dhe plotësuar me ndryshimet ligjore që janë kryer gjatë periudhës së përdorimit të saj (1999-2014), veçanërisht me zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 *“Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”*,

b. Rregullorja tip e funksionimit të ZVRPP-së Kavajë dhe Organigrama në përputhje me Strukturën Organizative, kjo e harmonizuar me përmbajtjen, përcaktimet, përshkrimet e vendeve të punës, vënien e sistemit të IT-së në funksion të plotë, me synim ngritjen dhe funksionimit e Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) të Njesisë publike(ZVRPP), si dhe rritjen e transparencës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj publikut. Këto masa të merren në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*.

2. Nga ZQRPP të rishikohen, urdhrat e nxjerra nga Kryeregjistruesi, respektivisht: nr. 1049, datë 10.9.2012 *“Për zbatimin e VKM nr. 576, datë 29.8.2012 “Për caktimin e Listës së shërbimeve që ofron ZRPP”*, urdhri nr. 1191, datë 5.11.2012 *“Për afatet e trajtimit dhe përpunimit të kërkesave nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”*, ku afati maksimal i përfundimit të procedurës zgjat nga 1 deri 30 ditë, pasi:

Nga auditimi i ushtruar në ZVRPP Kavajë, ka rezultuar se:

Urdhrat administrativ të trajtuara mësipërm, nuk u japin zgjidhje problemeve në këto drejtime:

- Disa qindra praktika kanë mbetur ende tek punonjësit edhe pas dërgimit të Aktverifikimeve (AV), brenda afatit mujor, të paktën gjatë fundvitit 2011 dhe 2012, ndërkohë që këto duhej të arkivoheshin në arkivë, sipas rregullave,ndërkohë duhej bërë njoftim përfundimtar kërkuësit, duke e vënë në dijeni se praktika ndodhet e arkivuar, si

dhe për shërbimin e pa marrë (dokumentin e pa marrë), është kreditor për shumën përkatëse të vlerës së paguar në aplikim. Kjo masë do të rriste transparencën ndaj publikut dhe do të rriste integritetin e ZVRPP-së dhe të punonjësve të saj.

- Të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e kryera për aplikimet e qytetareve dhe mos përfundimi i praktikave ose në proces, janë të ardhura të arkëtuara pa u kryer shërbimi-produkt nga kjo zyrë për qytetarin, megjithëse ka kryer pagesë por nuk ka marrë produktin- shërbimin e kërkuar.

Nga llogaritje e përafërt me një tarifë mesatare, rezulton se gjatë vitit 2011- deri në 9 mujin 2013 të ardhurat e realizuara nga aplikimet e mbetja e praktikave në proces arrijnë deri vlerën 3741 mijë lekë.

Nuk është çelur llogaria “Kreditorë për shërbime të pa kryera dhe në proces”, ku të evidentoheshin këto të ardhura të marra nga qytetarët për shërbime të pa kryera, si dhe nuk janë arkivuar praktikat në arkivë, duke mos i lënë në raftet e punonjësve me afate 1-2 e më shumë vite, në kundërshtim me afatin e përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative (KPA). Me sjelljen e dokumentacionit të munguar nga qytetarët duhet të vazhdonin procedurat e tërheqjes së praktikës për përpunim nga arkiva dhe përfundimin

(mbylljen) e praktikës, me përfundimin e kryerjes së shërbimit ndaj qytetarit. Kjo mënyre të vepruar rrit transparencën, shmang varësinë e qytetarit dhe krijimin e idesë së subjektivizmit dhe apo dhe të paragjyqimit të shërbimit të kësaj zyre shtetërore ndaj qytetarit taksapagues.

- Dorëzimi dhe arkivimi në arkivë i praktikave në proces menjëherë pas kryerjes së aktverifikimit nga punonjësi përpunues dhe dërgimit apo njoftimit të qytetarit, bashkë me njoftimin, t’i bëhet e ditur qytetarit se kjo zyrë është kreditor ndaj tij për shumën e paguar dhe shërbimin e pakryer e lënë në proces, si dhe dokumentacioni i tij ndodhet i administruar e arkivuar pranë ZVRPP-së, në pritje deri në 1 muaj, pas këtij afati qytetarit aplikues duhet tu kthehet shuma e paguar.

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

1. Regjistruesi i ZVRPP Kavajë, të marrë masa të kërkojë verifikimin e titujve të pronësisë pranë Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Qarkut Tiranë në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” i ndryshuar, të Udhëzimit (KM) nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin” e akteve nënligjore në zbatim të tyre, **dhe konkretisht:**

a. Për 31 pasuritë me sipërfaqe totale **107364 m<sup>2</sup>**, që **i përkasin 20 AMTP-ve** lëshuar në **ZK. 3501, Spille** sipas tabelës “**Toka përfitur me AMTP të Parregullta dhe pa Certifikata të Gjendjes Familjare datë 01.08.1991 ZK 3501 Spille**”.

**Brenda muajit Korrik 2014**

2. Regjistruesi i ZVRPP Kavajë të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 për **10 pasuri me sipërfaqe totale 27744 m<sup>2</sup>, toka , regjistruar dhe pajisur mbajtësi me certifikatë pronësie të cilat nuk janë tjetërsuar, mbetur gjendje tek**

*mbajtësi i parë, pasqyruar në tabelën “Gjendja dhe shitjet e tokave bujqësore fituar me AMTP pa Certifikata të Gjendjes Familjare datë 01.08.1991 ZK 3501 Spille”.*

**Menjëherë**

**3.** Regjistruesi i ZVRPP Kavajë të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60 dhe 74, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur tekniko ligjor, konkretisht:

a. 1. Për pasurinë nr. 56/42 v. 3, f. 96, ZK 3497, *Spanesh e llojit vresht me sipërfaqe 4200 m<sup>2</sup> sipas AMTP nr. 127/1, datë 16.7.2006 deri në plotësim të dokumentacionit dhe të kërkohet verifikimi i titujve të pronësisë duke zbatuar UKM nr. 2, datë 8.4.2009 “Për Mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike, për Pasuritë e Paluajtshme, të fituara me AMTP”, pikën 3.1, germa (iii) me tej ndarë: në pasurinë nr. 56/41 v. 3, f. 95, e llojit vresht me sipërfaqe 10000 m<sup>2</sup> ZK 3497, Spanesh, e cila është shitur dhe nr. 56/42 v. 3, f. 96, e llojit vresht me sipërfaqe 4200 m<sup>2</sup> ZK 3497, Spanesh për të cilat është lëshuar certifikatë.*

**Menjëherë**

a. 2. Për pasurinë nr. 308/115 v. 13, f. 248 ZK 3774, *Vil-Ballaj Bashtovë Gose e llojit arë me sipërfaqe 6400 m<sup>2</sup> në emër të qytetarit B.M., përrfituar me AMTP nr. 582 për 7000 m<sup>2</sup>, në fakt në kartelë përcaktohen 6400 m<sup>2</sup>, dhe të kërkohet verifikimin e titullit të pronësisë pranë KVVTP Qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin” dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre. Trajtuar hollësisht në faqet nr. 33-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

**b.** *Për 67 pasuri bujqësore me sipërfaqen totale prej 65283 m<sup>2</sup> të llojit arë dhe arë+truall, nga të cilat në ZK 3960 Fshati Kazie, deri në kryerjen e veprimeve në KPP për identifikimin, veçimin dhe regjistrimin e sipërfaqeve tepër ne pronësi Seksioni C “shtet”, në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991”Për tokën”, i ndryshuar, pasqyruar në tabelën nr. 2 “Pasuri me sipërfaqe tepër mbi AMTP pa kryer veprime në Kartela ZK 3960 Fshati Kazie Rrethi Kavajë”. Trajtuar më hollësisht në faqet 44-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Brenda muajit Korrik 2014**

**c.** Për 14 pasuri bujqësore me sipërfaqe totale 11245 m<sup>2</sup>, të llojit arë dhe arë+truall ZK 3960 Fshati Kazie Rrethi Kavajë për të cilat janë kryer transaksione dëshmi trashëgimie dhe kontrata shitblerje, deri në kryerjen e veprimeve në KPP mbi pasuritë e tjera të AMTP-ve, me nr. 811, nr.797, nr. 822, nr.830. nr. 831, për identifikimin, veçimin e sipërfaqeve tepër dhe regjistrimin ne pronësi “shtet”, Seksioni C, përrfituar tepër si pasojë e aplikimit të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991”Për tokën”, i ndryshuar, pasqyruar në tabelën nr. 3 “Pasuri me sipërfaqe tepër mbi AMTP, Lëshuar certifikata dhe kryer transaksione shitje sipas veprimeve në Kartela ZK 3960 Fshati Kazie Rrethi Kavajë”, Trajtuar më hollësisht në faqet 44-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4. Nga Regjistruesi i ZVRPP Kavajë të merren masa dhe të mos kryhet asnjë veprim juridik apo transaksion mbi pasuritë bujqësore, pa kryer më parë rakordimet e përputhshmërisë ndërmjet sipërfaqeve sipas titullit të pronësisë AMTP, me sipërfaqen në fakt sipas matjeve të Printim III,(LN) dhe duke konfirmuar verifikimin e titullit të pronësisë në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991”Për tokën”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

**Vazhdimisht**

5. Nga Regjistruesi i ZVRPP Kavajë të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore në zbatim të përcaktimeve të **nenit 59, 60, 74 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”**, për nxjerrjen e urdhrin administrativ **për regjistrimin e kufizimit**, me afat dhe në përputhje me formën e përmbajtjen e aktit administrativ, **të pasurisë nr. 284/2, ZK nr. 3774**, në fshatin Vilë Bashtovë me afat deri në rivlerësimin e praktikës dhe dokumentacionin e nevojshëm ligjor, nga Ministria e Drejtësisë dhe Zyra e Avokatit të Shtetit (ZASH) për Vendimin e ZAKKP Tiranë, nr. 276, datë 10.09.2008, me një sipërfaqe të kthyer prej 42 127 m<sup>2</sup>. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 11-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

6. Nga Regjistruesi i ZVRPP Kavajë, të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore duke nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, 60, 75 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, për regjistrimin fillestar të 177pasurive regjistruar në ZK 3774, fshati Vilë Ballaj për 124 pasuri me 650 526 m<sup>2</sup> dhe ZK 1512, fshati Domen për 53 pasurive me 274038 m<sup>2</sup> sipas pasqyrave ”AMTP të Dyta periudha 2000 ZK nr. 1512 Domen “,dhe ”AMTP të Dyta periudha 2004-2008 ZK nr. 3774 Vilë Bashtovë” si dhe për këto pasuri të kërkojë verifikimin e titujve të pronësisë pranë KVVTP Qarku Tiranë , në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin” dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 46-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

7. Nga Regjistruesi i ZVRPP Kavajë të merren masa dhe të mos kryhen regjistrime në rastet e AMTP-ve të plotësuara në zërin kadastral “arë”, “pemishte” kur pasuria mëmë në kartelat e pasurive të paluajtshme ekziston e hapur “pyll”, pra me ndryshim të zërit kadastral.

Në lidhje me sipërfaqen 6895 m<sup>2</sup> të regjistruar më shumë nga sa justifikohet ndryshimi i zërit kadastral nga pyll në arë regjistruar volum 4, faqe 104 për parcelën 96/3 të ZK 1512, fshati Domen, lihet në kompetencë të regjistruesit saktësimi i përfituesve nga kjo sipërfaqe.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

8. Për regjistrimin e pasurive të përfitur nga ligji nr. 8405, datë 17.09 1998 “ Për Urbanistikën”, i ndryshuar, të merren masa për zbatimin e Urdhrit nr. 6, datë 21.01.2001 dalë në zbatim të nenit 3 të ligjit 7843, datë 13.07.1994 (për plan-vendosjen dhe studimin urbanistik) dhe të shihen në origjinë marrëdhëniet e pronësisë me truallin.

**Vazhdimisht**

9. Për pasuritë (shtëpitë me pronar) të cilat evidentohen, por nuk dokumentohet trualli me dokumentacion ligjor pronësie sipas nenit 193 të Kodit Civil të bëhet shënimi në seksionin “E “dhe me paraqitjen e dokumentacionit për blerje apo kalim në pronësi nga institucionet që kanë në kompetencë të kryhen veprimet për truallin, dhe në vijimësi të zbatohet vendimi KM nr. 745, datë 24.10.2012 dhe 608, datë 05.09.2012 kur nuk ka dokumentacion ligjor pronësie për truallin.

**Vazhdimisht**

10. Nga Regjistruesi i ZVRPP Kavajë, të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për vendosjen e kufizimit në bazë të pikës 1,nenit 5, neni 39, pika 1 e nenit 49, 59 dhe neni 74 të ligjit 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” bazuar në shkeljet e konstatuara, të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit **për 17 pasuri** të evidentuara në procesverbalin nr. 19, datë 20.02.2014 për sipërfaqen **34028 m2**, sipas pasqyrës nr. bashkëlidhur deri në verifikimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të nga KVTP pranë Prefekturës Tiranë.**(ZK 2099 Karpen, 2291 Kryemëdhej, 1791 Golem dhe 3501 Spille),**

**Brenda datës 30.08.2014**

11. Nga Regjistruesi ZVRPP Kavajë të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore duke nxjerrë urdhër kufizimi në bazë të ligjit 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën Bujqësore” neni 1 dhe neni 9, t’i kërkojë KVTP pranë prefekturës Tiranë verifikimin e AMTP, bazuar në shkeljet e konstatuara **në 17 raste me sipërfaqe 34028 m2**, të evidentuara në Raport Auditimi dhe procesverbalit nr. 19, datë 20.02.2014.(pasqyra nr... bashkëlidhur raportit Përfundimtar të Auditimit. **(ZK 2099 Karpen, 2291 Kryemëdhej, 1791 Golem dhe 3501 Spille).**

**Brenda datës 30.08.2014**

12. Nga Regjistruesi ZVRPP Kavajë të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore duke nxjerrë urdhër kufizimi në bazë të ligjit 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” neni 5 pika 1, neni 39, neni 49 pika 1 dhe neni 59 bazuar në shkeljet e konstatuara në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 30 dhe 38/1 dhe me urdhrit të regjistruesit nr. 2532/1, datë ZRPP nr. 2532/1, date 21.04.2009, për 11 subjekte të evidentuara në pasqyrën **“Pasqyra e kufizimeve për Lejet e legalizimeve për 11 Subjekte”**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit deri në konfirmimin e dokumentacionit ligjor si persona të stimuluar, në zonë të stimuluar, për veprimtari të stimuluar nga ALUZNI në të kundërt të kërkohet arkëtimi në rrugë ligjore i detyrimi.

**Brenda datës 30.08.2014**

13. Nga Regjistruesi ZVRPP Kavajë të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore duke nxjerrë urdhër kufizimi në bazë të ligjit 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e

pasurive të paluajtshme” neni 5 pika 1, neni 39, neni 49 pika 1 dhe neni 59, dhe në bazë të ligjit 9948, datë 07.07.2008 “ Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të

pronësisë mbi tokën Bujqësore” neni 1 dhe neni 9, të kërkojë KVTP pranë prefekturës Tiranë verifikimin e AMTP, bazuar në shkeljet e konstatuara, verifikimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën Bujqësore nga KVTP pranë Prefekturës Tiranë për regjistrimet e kryera Për vitin 2009 dhe 2013 në emër të **A.H. dhe A.E.**, të cilët kanë dhe përfituar sipas me AMTP të dyta të plotësuara në vitin 2000.

**-A.E.** ka përfituar 8400 m<sup>2</sup> me AMT 1582, datë 07.12.2000 duke u ndryshuar zëri nga Pyll në tokë arë.

**-A.H.** me aktin nr. 142, pa datë ka përfituar 1200 m<sup>2</sup> dhe me aktin nr. 1211, datë 14.11.2000 përfituar 4700 m<sup>2</sup> duke u ndryshuar zëri kadastral nga Pyll në tokë arë pa miratim të organeve kompetente. (**ZK 3960 Kazie**).

#### **Brenda datës 30.08.2014**

**14.** Nga Regjistruesi ZVRPP Kavajë të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore duke nxjerrë urdhër kufizimi në bazë të ligjit 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” neni 5 pika 1, neni 39, neni 49 pika 1 dhe neni 59 bazuar në shkeljet e konstatuara, të evidentuara në Raport Auditimi Auditimit deri në verifikimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën Bujqësore nga KVTP pranë Prefekturës Tiranë për regjistrimet e kryera në vitin 2003 dhe 2004 në parcelën nr. 1, sipas pasqyrës “**AMTP të dyta të viteve 2003-2004 për sipërfaqen prej 129605 m<sup>2</sup> ZK 3960**”.

#### **Brenda datës 30.08.2014**

**15.** Nga Regjistruesi ZVRPP Kavajë të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore dhe të kryejë veprimet në Kartelat e Pasurive të Paluajtshme, si më poshtë;

**a.** për vendosjen e kufizimit, çregjistrimin, dhe tërheqjen e certifikatave të pronësisë lëshuar datë 15.3.2011 në emër të Komunës Synej pa pasur tituj pronësie, në kundërshtim me *VKM nr. 45, datë 19.01.2011, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike dhe shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Synej të Qarkut Tiranës”*, kthimin dhe regjistrimin në emër të pronarit “Shtet” të 7 pasurive me sipërfaqe *totale 600139,556 m<sup>2</sup>*, ndodhur në ZK 2909, Peqinaj Komuna Synej, dhe konkretisht pasuritë: *nr. 1/1, v. 4, f. 88, sip. 553139,56 m<sup>2</sup> Pyll, nr. 2/60, v. 4, f. 89, sip. 6000 m<sup>2</sup> arë, nr. 219, v. 4, f. 90, sip. 3500 m<sup>2</sup> truall, nr. 102, v. 4, f. 91, sip. 4000 m<sup>2</sup> arë, nr. 103, v. 41, f. 92, sip. 2000 m<sup>2</sup> truall, nr. 104, v. 4, f. 93, sip. 7000 m<sup>2</sup> PF, nr. 105, v. 4, f. 94, sip. 24500 m<sup>2</sup> PF, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, ndryshuar, me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.*

**b.** për kthimin në gjendjen fillestare, në gjendjen juridike të mëparshme shtetërore dhe regjistrimin në KPP të zërave kadastral të ndryshuar të sipërfaqes *594 639,56 m<sup>2</sup> regjistruar në kategorinë truall* nga kategori e resurseve Pyll: 553139,56 m<sup>2</sup>, tokë pafryt 31500 m<sup>2</sup>, dhe nga kategori e resursit arë 10 000 m<sup>2</sup>, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr.

7843, datë 13.7.1994, ndryshuar, me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të ligjit nr. 8752, datë 28.3.2001 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”, ndryshuar me ligjin nr. 10257, datë 25.3.2010, “Për disa shtesa e ndryshime...” dhe me ligjin nr. 16/2012, datë 16.2.2012, si dhe në të Kreut të III “Procedurat për ndryshimin e kategorive të Resurseve” të VKM nr. 532, datë 31.10.2002 “Për mënyrën e ushtrimit të funksionimit nga Seksionet e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës ne Qark dhe në Zyrat e Menaxhimit të Mbrojtjes së tokës Komuna e Bashki”. Trajtuar hollësisht në faqet 101-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### Menjëherë

**16. KLSH, pasi ti njoftojë situatën Kryeministrit, ti rekomandohet dhe kërkohet, rishikimi dhe rishqyrtimi i lënies në fuqi të akteve nënligjore aktualisht në fuqi respektivisht:**

-VKM nr. 515, datë 18.7.2003 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi, Ministrisë Mbrojtjes”, ndryshuar me VKM nr. 737, datë 16.10.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 515, datë 18.7.2003”;

- VKM nr. 45, datë 19.01.2011, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike dhe shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Synej të Qarkut Tiranës”, VKM nr. 505, datë 30.5.2013 “Për Miratimin e Kontratës së Koncesionit, të Formës “BOT”, të lidhur Ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike e Transportit dhe Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “F...” LTD & “D...” SA, “Për Ndërtimin, Shfrytëzimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Portit të Jahteve ne Komunën Synej Kavajë”, pasi nga auditimi, rezulton se këto Vendime kanë mangësitë, pasaktësitë dhe mospërputhjet ligjore si më poshtë:

-Sipas VKM nr. 737, datë 16. 10.2012, i cili ndryshon VKM nr. 515, konstatojmë se: Pasuritë e përfshira më sipër dhe duke ju referuar fletës inventarit nr. 88 dhe nr. 89 të pronave , bashkëlidhur këtij vendimi , sipërfaqja nga 30000 m<sup>2</sup> rritet në 600139,56 m<sup>2</sup>, ose sipërfaqe më tepër 570139,56 m<sup>2</sup>.

Gjithashtu, sipas VKM nr. 737, datë 16. 10.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr.515, datë 18.7.2003 ” janë kthyer në truall dhe lëshuar certifikatat e pasurive në emër të Komunës Synej për pasuritë me sipërfaqet e mëposhtme:

1. Pasuria nr.1/1, v.4,f.88 sip. 553139,56 m<sup>2</sup> Pyll lëshuar certif. datë 15.3.2011
2. Pasuria nr.2/60, v.4,f.89, sip. 6000 m<sup>2</sup> arë certif. datë 15.3.2011
3. Pasuria nr.102, v.4,f.91, sip. 4000 m<sup>2</sup> arë certif. datë 15.3.2011
4. Pasuria nr.104, v.4,f.93, sip. 7000 m<sup>2</sup> PF certif. datë 15.3.2011
5. Pasuria nr.105, v.4,f.94, sip. 24500 m<sup>2</sup> PF, certif. datë 15.3.2011

Totali sip. 594639,56 m<sup>2</sup>

Mungojnë procedurat dhe VKM përkatëse për ndryshimin në kategorinë e resursit ”truall” për sipërfaqen 594 639,56 m<sup>2</sup> nga kategoritë e resurseve: 553139,56 m<sup>2</sup> “Pyll”, 31500 m<sup>2</sup> “tokë pafryt”, dhe 10 000 m<sup>2</sup> resursit “arë”.

Pra VKM nr. 737, datë 16. 10.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 515, datë 18.7.2003”; janë në kundërshtim me:

a-ligjin nr. 8752, datë 28.3.2001 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Strukturave për Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”, ndryshuar me ligjin nr. 10257, datë 25.3.2010 “Për disa shtesa e ndryshime...”

**b** - ligjin nr. 16/2012, datë 16.2.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001, neni 1, pika 4.5

c- ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” neni 25. Nëse i referohemi ligjit nr. 16/2012, datë 16.2.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001...” nenit 1, pika 4.5, ku shprehet se:”... *Ndryshimi i kategorisë së resursit tokë bujqësore në kategorinë e resurseve “pyll, kullotë, livadhe bëhet vetëm me kërkesë të pronarit të saj apo organit të qeverisjes vendore, i cili i ka në përdorim këto toka. Kërkesa për ndryshim paraqitet pranë Ministrisë, veprimtaria e së cilës mbulon këtë kategori resursi. Miratimi i ndryshimit bëhet: a. Për sipërfaqet deri në 5 ha, me urdhër të ministrit përkatës, b. Për sipërfaqet mbi 5 ha, me Vendim të Këshillit të Ministrave”*

### Menjëherë

**17.** Nga Regjistruesi ZVRPP Kavajë të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për të përfshirë në *rivlerësim të truallit përkatës në 5 rastet* e rivlerësuara të banesave 1-2 kt zk. 3234 Rrogozhinë dhe të vendosë në KPP *kapitalin në vlerën 10 167 071 lekë nga 9 874 146 lekë kundrejt arkëtimit të vlerës së shërbimit prej 2927,<sup>10</sup> lekë*, në zbatim të nenit 9 e 27 të ligjit nr. 10418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor”, dhe udhëzimit të MF nr. 12, datë 21.4.2011 “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 10418..”, urdhrit regjistruetit nr. 455, datë 6.6.2011 “Për shtimin në ZVRPP të shërbimit për rivlerësim të pasurive të paluajtshme”.

### Menjëherë

**18.** Nga Regjistruesi ZVRPP Kavajë të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për zbatimin e *detyrimit për kthimin dhe regjistrimin në emër të pronarit “shtet” nga zbatimi i 14 vendimeve të gjykatave për 3 vitet 2011, 2012 dhe 2013 të 16 pasurive me sipërfaqe 42 951 m<sup>2</sup>, që i përkasin AMTP–ve të shpallura absolutisht të pavlefshme dhe konkretisht:*

**a.** *-Për vitin 2013*, nuk janë regjistruar me pronar “shtet” 3 pasuri me **3506 m<sup>2</sup>** (pasuria nr. 295/220, v.13, f.13, **1500 m<sup>2</sup>**, ZK. 3774 *ende në pronësi të L.Gj.* pasuria nr. 295/90, v.11, f.117, me **1003 m<sup>2</sup>**, ZK. 3774 dhe pasuria nr. 295/91, v.11, f.118, me **1003 m<sup>2</sup>**, ZK. 3774, *ende në pronësi të S.L.*;

**b** - *Për vitin 2012*, nuk janë regjistruar me pronar “shtet” 6 pasuri *bujqësore* me sipërfaqe **27975 m<sup>2</sup>** nga të cilat: 3 pasuri me sipërfaqe totale **3100 m<sup>2</sup> ZK 2099 Karpen** (pas. nr. 11/16, v.9, f. 215, me 1000 m<sup>2</sup>, ZK 2099 *ende në pronësi të I.B.*; pasuria. nr. 11/33, v. 10,f.85 me **1500 m<sup>2</sup> ZK 2099 Karpen**, *ende në pronësi të M.M.* dhe pasuria nr. 11/62, v. 10, f. 197 me **600 m<sup>2</sup> ZK 2099 Karpen** *ende në pronësi të R.S.*), pasuria me parcelat nr. 91,95,96 lagje Sallbeg me **12075 m<sup>2</sup>**, ZK.8551 *ende në pronësi të B.C.*, zonë e cila nuk ka hyrë në sistem; pasuria nr. 53/5, v.2,f.153, me **6900 m<sup>2</sup> ZK. 3940**, Zikxhafaj, *ende në pronësi të Shpresa H.B.*; dhe pasuria nr.

200/0, v. 2, f.114 me **5900 m<sup>2</sup>** parcela nr.57 ZK 3204 Rrakull *ende në pronësi të J.T.*



*c -Për vitin 2011, nuk janë regjistruar me pronar “shtet” 5 vendime për sipërfaqen 11470 m<sup>2</sup> (pasuria nr. 96/51, v. 4,f.216, me 400 m<sup>2</sup>, ZK 1512, ende në pronësi të familjes Elmadhi; pasuria nr. 37/44,v. 12, f. 111, me 3000 m<sup>2</sup> ZK 3501 Spille, ndarë në -pasuria nr. 37/133, v.12,f. 226 me 1000 m<sup>2</sup> dhe -pasuria nr .37/134,v. 12, f. 227 me 2000 m<sup>2</sup>, të cilat ende në pronësi të D.P.pasuria nr. 11/42, v. 10, f. 114 me 2000 m<sup>2</sup> ZK 2099 Karpen Golem ende në pronësi të Ç.D.; sipas 4 tabelave bashkëlidhur: “Regjistrimi i zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe të Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë v. 2011.1, v. 2011,2, v. 2012 dhe v. 2013”.*

#### **Menjëherë**

**19.** Nga Regjistruesi ZVRPP Kavajë të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore duke nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **nenit 74** dhe nenet 45, 59, 60 mbi **pasuritë e tjera bujqësore që i përkasin 5 AMTP-ve të familjeve bujqësore** ku, për disa prej pasurive, gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVVTP, mbajtës të AMTP-ve dhe detyrimin e pagesës prej **2 730 mijë lekë** të vlerës së tokës me **sipërfaqe 7640 m<sup>2</sup> të tjetërsuar e shitur në vlerën 8007 mijë lekë** sipas kontratave të shitjes, në zbatimin e Vendimeve të Gjykatave, dhe konkretisht ndaj familjeve bujqësore si:

**1. H.S., mbajtës i AMTP nr. 516/1, datë 17.6.2003, për detyrimin VGj nr. 3410, datë 27.12.2010** barrë në vlerën e tokës **137000 lekë** të sipërfaqes shitur 1000 m<sup>2</sup> (nr. 2, sipas tabelës v. 2011.1);

**2. A.K., mbajtës i AMTP pa nr. dhe pa datë, për sipërfaqen 1750 m<sup>2</sup> për detyrimin VGj nr. 748, datë 24. 3.2011** si barrë në vlerën e tokës **378 000 lekë** të sipërfaqes shitur 1750 m<sup>2</sup> (nr. 4, sipas tabelës v. 2011.1);

**3.P.P mbajtës i AMTP nr. 558/1, pa datë , për detyrimin VGj nr. 363, datë 10.2.2011,** barrë në vlerën e tokës **775600 lekë** të sipërfaqes shitur 1400 m<sup>2</sup> (nr. 5, sipas tabelës v. 2011.1);

**4. B. M. mbajtës i AMTP nr. 309/1, datë 13.5.2002, për detyrimin VGj nr. 2549, datë 5. 10.2011,** barrë në vlerën e tokës **614 000 lekë** të sipërfaqes shitur **2000 m<sup>2</sup>** (nr. 5, sipas tabelës v. 2011.2);

**5. Sh.D.mbjtës i AMTP nr. 1810/1, datë 25.4.2003, për detyrimin VGj nr. 2534, datë 17. 10.2011,** barrë në vlerën e tokës **614 000 lekë** të sipërfaqes shitur **1490 m<sup>2</sup>** ( nr. 7, sipas tabelës v. 2011.2), sipas tabelës “**Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe të Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë viti 2011/1 dhe 2011/2**“, si dhe mbi **pasuritë e tjera bujqësore që i përkasin 6 AMTP-ve të familjeve bujqësore** ku, për disa prej pasurive, gjykata ka vendosur pavlefshmëri për të paditurit nga KVVTP, mbajtës të AMTP-ve dhe detyrimin e pagesës prej **5277,1 mijë lekë** të vlerës së tokës me **sipërfaqe 28644 m<sup>2</sup> të tjetërsuar e shitur në vlerën 10 583,9 mijë lekë sipas kontratave të shitjes**, në zbatimin e Vendimeve të Gjykatave, dhe konkretisht ndaj familjeve bujqësore si:

**1. E.D. mbajtës i AMTP nr. 218/1, datë 203.2003 për detyrimin VGj nr. 826, datë 26.3.2013,** barrë në vlerën **164 000 lekë, të sipërfaqes shitur 1000 m<sup>2</sup>** ( nr. 1 sipas tabelës v. 2013),

**2. Xh.El. mbajtës i AMTP nr. 1386/1, datë 7.9.1999, për detyrimin VGj nr. 557, datë 27.2.2013,** barrë në vlerën **1579 900 lekë, të sipërfaqes shitur 6100 m<sup>2</sup>** ( nr. 2, sipas tabelës v. 2013)

